

VENDIM
Nr. 26, datë 9.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 9.4.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 11 (L) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: Lirana Demaj dhe Leonard Demaj, të përfaqësuar nga avokat Durim Barjamaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group” sh.a., përfaqësuar nga Admir Kallembi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1534 (209), datë 12.4.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group” sh.a. (*OSHEE Group*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Më datë 14.9.2008, gjatë riparimit të një defekti në nënstacionin e Mifolit në fshatin Skrofotinë, H.D., i punësuar si elektrikist pranë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (sot “OSHEE Group” sh.a.), ka rënë në kontakt me rrymën elektrike, si rrjedhojë e së cilës ka ndërruar jetë më datë 11.10.2008. Sipas vendimit nr. 2948, datë 25.11.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, i ndjeri ka lënë pas bashkëshorten e tij F.D., si dhe fëmijët A.D., S.D., Leonard Demaj dhe Lirana Demaj.

2. Duke pretenduar se shkak i vdekjes së të ndjerit kanë qenë veprimet me faj në formën e pakujdesisë së rëndë të punonjësve të “CEZ Shpërndarje” sh.a., F.D., A.D. dhe S.D. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi për detyrimin e “CEZ Shpërndarje” sh.a. të paguajë në favor të tyre dëmin real pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga vdekja e të ndjerit H.D. Me vendimin nr. 1908, datë 19.6.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pranimin e

padisë, duke detyruar “CEZ Shpërndarje” sh.a. të dëmshpërblejë paditësit në vlerën 8.925.837 lekë, si dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jopasuror, për shkak të humbjes së jetës së familjarit të tyre, H.D. Ky vendim ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 86 (60-2013-119), datë 6.2.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

3. Më datë 28.10.2013 Lirena Demaj dhe Leonard Demaj (*kërkuesit*) i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e të paditurit “CEZ Shpërndarje” sh.a. të dëmshpërblejë secilin prej tyre në shumën 2.065.945 lekë për dëmin moral dhe po të njëjtën shumë për dëmin ekzistencial, të shkaktuar si rrjedhojë e vdekjes së babait të tyre, si dhe detyrimin e të paditurit të paguajë shpenzimet gjyqësore në shumën 280.000 lekë. Në gjykim, pala e paditur ka pretenduar, ndër të tjera, se, në bazë të nenit 115, shkronja “dh”, të Kodit Civil (KC), padia ishte parashkruar dhe se asgjë nuk e kishte penguar përfaqësuesen ligjore të paditësve të ushtronte padinë brenda afatit ligjor 3-vjeçar të përcaktuar nga kjo dispozitë. Në përfundim të gjykimit të çështjes, me vendimin nr. 1277, datë 21.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e padisë, për shkak të parashkrimit të saj.

4. Ndaj ankimit të kërkuarve, me vendimin nr. 321, datë 23.3.2016, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, për shkak se në kohën kur ka ndodhur ngjarja, në të cilën ka gjetur vdekjen babai i tyre, paditësit kanë qenë të mitur, për rrjedhojë afati i parashkrimit ishte pezulluar deri në momentin që ata do të mbushnin moshën për të fituar zotësinë e plotë për të vepruar. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a.

5. Me vendimin nr. 00-2023-1534 (209), datë 12.4.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 321, datë 23.3.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1277, datë 21.7.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky kolegji ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit, sipas të cilit afati i parashkrimit pezullohej vetëm në rast se paditësi, krahas qenies i mitur, ishte edhe pa përfaqësues ligjor, për rrjedhojë në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtën e padisë.

6. Më datë 2.8.2023 kërkuarët i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 6.9.2023. Më datë 25.10.2023 Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë parashtruar se u janë cenuar:

7.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

7.1.1 *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Duke prishur vendimin e gjykatës së apelit, ajo nuk ka pasur parasysh se vendimi i kësaj gjykate nuk ka zgjidhur çështjen në themel dhe, si i tillë, nuk është përfundimtar në këndvështrim të nenit 126 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Rrethanat dhe provat nuk i janë nënshtruar vlerësimit juridik dhe gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara nga palët në kërkesëpadi e gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk mund t'i jepte zgjidhje përfundimtare çështjes, por duhej ta kthente për rishqyrtim, duke u shprehur vetëm për sa i përket faktit se cila gjykatë do të rishqyrtonte çështjen. Në këto kushte, kërkuarët u është cenuar e drejta e shqyrtimit të çështjes në një shkallë gjykimi.

7.1.2 *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në mungesë të palëve. Po kështu, nga pjesa arsyetuese e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që kjo gjykatë të ketë bërë kalimin procedural nga “CEZ Shpërndarje” sh.a. në “OSHEE Group” sh.a., në zbatim të nenit 199, paragrafi i dytë, të KPC-së.

7.2 *Parimi i sigurisë juridike* në drejtim edhe të *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë bie në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër krejtësisht të ngjashëm të saj, atë nr. 610, datë 18.12.2012, që bën fjalë për afatet e parashkrimit të padisë së të miturve, rregullit interpretues të të cilit duhet t'i përmbahej. Vendimet e Gjykatës së Lartë perceptohen si burime të pritshme ligjshmërie, çka është pranuar edhe me ndryshimet e nenit 472 të KPC-së për sa u përket shkaqeve për rekurs, ku përcaktohet si i tillë edhe rasti kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil. Për rrjedhojë, në çështjen e tyre Gjykata e Lartë duhej t'i përmbahej rregullit interpretues të bërë në vendimin nr. 610, datë 18.12.2012 të saj. Dhënia e dy vendimeve të kundërta për situata faktike dhe ligjore thelbësisht të ngjashme zhvlehtëson besueshmërinë në sistemin gjyqësor dhe shtetin e së drejtës.

8. **Subjekti i interesuar**, "OSHEE Group" sh.a., ka prapësuar se:

8.1 Pretendimet e kërkuësve janë të pambështetura në ligj dhe në prova. Sipas nenit 112 të KC-së parashkrimi kërkon kalimin e një periudhe kohe dhe mosveprimin e titullarit për ushtrimin e së drejtës gjatë kësaj kohe, ndërsa sipas nenit 117 të këtij kodi afati i parashkrimit të padisë fillon nga momenti i lindjes së të drejtës. Në rastin konkret bëhet fjalë për padi për shpërblimin e dëmit jashëkontraktor, e cila i nënshtrohet afatit 3-vjeçar të parashkrimit, sipas nenit 115, shkronja "dh" të KC-së, afat i cili, sipas nenit 120 të këtij kodi, ka filluar të ecë nga data 11.10.2008 kur ka ndodhur ngjarja, datë në të cilën kërkuësit kanë marrë dijeni për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë. Gjykata e apelit arsyeton në mënyrë të gabuar kur referon se shprehja "gjersa t'u emërohet përfaqësuesi" zbatohet për personat që nuk kanë zotësi për të vepruar, ndërsa shprehja "të fitojnë zotësinë për të fituar" për të miturit.

8.2 Kërkuësve u është njoftuar rekursi dhe nuk rezulton të kenë paraqitur kundërrekurs.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vlerëson se kërkuësit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "P" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuësit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Po kështu, kërkuësit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 12.4.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë më datë 2.8.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuësit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar

me ligj e të së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe të parimit të sigurisë juridike në drejtim edhe të parimit të barazisë së ligjit dhe mosdiskriminimit, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata konstaton se ato për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim edhe të parimit të barazisë së ligjit dhe mosdiskriminimit kanë të bëjnë, në thelb, me procesin e zhvilluar nga Gjykata e Lartë.

14. Po kështu, për sa i takon së drejtës për t'u dëgjuar, kërkuesit kanë pretenduar si shkak për cenimin e saj shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë në mungesë të palëve. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar. Përkundrazi, në këto raste debati i palëve realizohet njësoj, pavarësisht formës së paraqitjes së argumenteve me shkrim, pra përmes shkëmbimit respektiv dhe në kohën e duhur të parashtrimeve, prapësimeve dhe provave dokumentare të paraqitura (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata eidenton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes rekursit të paraqitur nga shoqëria "CEZ Shpërndarje" sh.a., i cili, sipas akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues të çështjes, i është njoftuar përfaqësuesit të kërkuesve më datë 13.12.2016 dhe për të nuk rezulton të jetë paraqitur kundërrekurs, në zbatim të nenit 477 të KPC-së. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesve u është dhënë mundësia të shprehin qëndrimin e tyre për çështjen dhe për realizimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për rrjedhojë, për sa i përket këtij pretendimi, vlerëson se ata nuk kanë arritur të provojnë se si gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë ka cenuar thelbin e kësaj të drejte.

16. Në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuesit kanë pretenduar edhe se Gjykata e Lartë nuk ka kryer kalimin procedural nga "CEZ Shpërndarje" sh.a. në "OSHEE Group" sh.a., në zbatim të nenit 199, paragrafi i dytë, të KPC-së. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim Gjykata ka theksuar se moskrijimi i drejtë i ndërgjyqësisë cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të kontradiktoritetit në gjykim dhe barazisë së armëve. Megjithatë, pretendimi për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë duhet analizuar në aspektin e lidhjes së drejtpërdrejtë që ka ekzistenca e shkeljes ligjore me vetë kërkuesin, si dhe të ndikimit që kjo shkelje mund të ketë sjellë mbi ecurinë e procesit gjyqësor (*shih vendimet nr. 34, datë 29.5.2015; nr. 13, datë 18.5.2006; nr. 14, datë 15.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesve për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë, për sa i përket subjektit të interesuar, nuk është argumentuar nga pikëpamja kushtetuese, në eidentimin e të drejtave kushtetuese të cenuara kërkuesve për këtë shkak ose të pasojave që kjo ka sjellë në procesin në tërësi. Nga materialet e dosjes së tërhequr për qëllime të gjykimit kushtetues rezulton se gjatë gjykimit të çështjes në apel gjykata ka bërë kalimin procedural nga "CEZ Shpërndarje" sh.a. në "OSHEE" sh.a. (*shih procesverbalin e seancës së datës 26.1.2016, ora 10:23 të Gjykatës së Apelit Vlorë*) dhe ndonëse gjatë gjykimit të çështjes Gjykata e Lartë nuk ka bërë kalimin procedural nga "OSHEE" sh.a. në "OSHEE Group" sh.a., kjo nuk rezulton të ketë cenuar të drejta kushtetuese të kërkuesve.

18. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të parimit të barazisë përpara ligjit, kërkuesit kanë pretenduar se në interpretimin e dispozitave të KC-së për afatet e parashkrimit të padisë së të miturve për çështjen e tyre, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të kundërt nga ai i mbajtur në çështje të ngjashme. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme (*shih vendimin nr. 17, datë 23.3.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, ekzistenca e dy vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyra të ndryshme për zbatimin e ligjit, nuk përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, për aq kohë sa nuk ka një interpretim unifikues apo njësoj të saj në lidhje me çështjen (*shih vendimin nr. 4, datë 31.1.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, si dhe faktin se specifikat e çështjes së tyre janë të ndryshme nga çështja për të cilën ata kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim

të barazisë përpara ligjit nga Gjykata e Lartë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuësve nuk gjen mbështetje në aspektin kushtetues.

19. Për sa më lart, për sa u përket pretendimeve të kërkuësve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke mbajtur në konsideratë thelbin e tyre, Gjykata vlerëson t'i analizojë ato në këndvështrim të së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj në lidhje me të drejtën e aksesit substancial dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj në lidhje me të drejtën e aksesit substancial

20. Kërkuësit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka vepruar në tejkalim të kompetencave të saj. Ajo ka zgjidhur në mënyrë përfundimtare çështjen, ndonëse rrethanat dhe provat nuk i ishin nënshtruar vlerësimit juridik dhe gjykata e apelit nuk u kishte dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara nga palët në kërkesëpadi e gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke cenuar të drejtën e tyre për shqyrtimin e çështjes në një shkallë gjykimi. Sipas tyre, vendimi i gjykatës së apelit nuk ishte përfundimtar në kuptim të nenit 126 të KPC-së, për rrjedhojë Gjykata e Lartë nuk mund t'i jepte çështjes zgjidhje përfundimtare, por duhej ta kthente për rishqyrtim, duke u shprehur vetëm për gjykatën që do ta shqyrtonte atë.

21. Subjekti i interesuar, "OSHEE Group" sh.a., ka prapësuar se pretendimet e kërkuësve janë të pabazuara dhe arsytimi i gjykatës së apelit është i gabuar, pasi në rastin konkret bëhet fjalë për padi për shpërblimin e dëmit jokontraktor, e cila i nënshtrohet afatit 3-vjeçar të parashkrimit, sipas nenit 115, shkronja "dh", të KC-së, afat i cili, sipas nenit 120 të këtij kodi, ka filluar nga data 11.10.2008 kur ka ndodhur ngjarja, datë në të cilën kërkuësit kanë marrë dëmin për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë. Gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë të gabuar kur referon se shprehja "gjersa t'u emërohet përfaqësuesi" zbatohet për personat që nuk kanë zotësi për të vepruar, ndërsa shprehja "të fitojnë zotësinë për të fituar" për të miturit.

22. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Sipas Gjykatës, shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 25.4.2023; nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 7, datë 21.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kuptim të sa më sipër, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, tashmë Gjykata ka qëndrim të konsoliduar se, në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion për më tepër i Gjykatës së Lartë. Gjykata ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 16, datë 16.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është iniciuar nga kërkuësit, të cilët i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi për shpërblimin e dëmit moral dhe ekzistencial, të shkaktuar nga veprimet me faj në formën e pakujdesisë së rëndë të punonjësve të "CEZ Shpërndarje" sh.a., si rrjedhojë e të cilave ka gjetur vdekjen babai i tyre. Gjatë gjykimit të çështjes, "CEZ Shpërndarje" sh.a. ka prapësuar se, bazuar në nenin 115, shkronja "dh", të KC-së,

që përcakton parashkrimin brenda 3 vjetëve të padisë për shpërblimin e dëmit jokontraktor, padia objekt gjykimi është parashkruar, pasi nga marrja dijeni e kërkuësve për dëmin dhe shkaktarin kanë kaluar mbi 3 vjet, ndërkohë që asgjë nuk ka ndaluar përfaqësuesen e tyre ligjore të ushtrojë padinë brenda afatit ligjor, ndërsa kërkuësit kanë prapësuar se në rastin e tyre afati i parashtrimit është pezulluar, pasi më datë e lindjes së të drejtës së padisë ata kanë qenë të mitur.

26. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 1277, datë 21.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e padisë si të parashkruar, duke vlerësuar se, në interpretim të neneve 115, 117 dhe 120 të KC-së, e drejta e padisë ka lindur më datë 11.10.2008, kur ka ndodhur ngjarja, ndërsa kërkesëpadia është paraqitur më datë 28.10.2013, pra 5 vjet e 17 ditë pas datës së lindjes së të drejtës. Po sipas gjykatës, prapësimet e kërkuësve për pezullimin e afatit të parashkrimit janë të pabazuara, pasi rrethanat e parashikuara nga neni 129, shkronja “d”, i KC-së për pezullimin e parashkrimit për paditë e të miturve kanë të bëjnë me rastet kur ata nuk kanë përfaqësues ligjor ose 6 muaj pasi është caktuar një i tillë dhe jo kur ata kanë pasur një të tillë dhe ky i fundit mund të ushtronte të drejtën e padisë në emër e për llogari të tyre (*shih vendimin nr. 1277, datë 21.7.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, faqet 3-4*).

27. Ndaj ankimit të kërkuësve, me vendimin nr. 321, datë 23.3.2016, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se kërkuësit kanë qenë të mitur në kohën kur ka ndodhur ngjarja. Sipas gjykatës së apelit, në interpretim të neneve 112 dhe 129, shkronja “d”, të KC-së, në rastin e të miturit ligjvënësi ka parashikuar pezullimin e afatit të parashkrimit, si rrjedhojë e mosveprimit të titullarit për të ushtruar këtë të drejtë gjatë kësaj kohe, jo për shkak të tij, por për shkak pamundësie objektive të kësaj kategorie subjektsh, çka lidhet me mungesën e zotësisë për të vepruar, pra të aftësisë që me veprimet e tij të ushtrojë të drejtat subjektive dhe të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve. Në rastin e të miturit parashkrimi pezullohet deri sa ai të fitojë zotësinë e plotë për të vepruar me mbushjen e moshës 18 vjeç, ndërsa ecja e afatit të pezulluar parashkohet vetëm në rastin e personit që nuk ka zotësinë për të vepruar, duke kuptuar këtu personat madhorë që, për shkak të sëmundjes psikike ose zhvillimit të metë mendor, u hiqet kjo zotësi, duke iu emëruar një përfaqësues ligjor. Po sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë ka llogaritur në kohën e parashkrimit të padisë periudhën nga ndodhja e ngjarjes deri në ngritjen e padisë, ndërkohë që parashkrimi ka qenë i pezulluar nga çasti i lindjes së detyrimit, aksidentit në të cilin ka gjetur vdekjen babai i paditësve, derisa këta të mbushnin moshën për të fituar zotësinë e plotë për të vepruar. Në rastin e kërkuësve ky pezullim do të vazhdonte deri pas 6 muajve nga koha kur Leonard Demaj do të fitonte zotësinë e plotë për të vepruar, duke u plotësuar kështu afati i plotë i parashkrimit shues më datë 7.12.2013, ndërkohë që për paditësen Lirëna Demaj ky afat ende vijonte të ishte i pezulluar, pasi ajo nuk kishte mbushur moshën për të fituar zotësinë e plotë për të vepruar (*shih vendimin nr. 321, datë 23.3.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë, faqet 4-5*).

28. Ndaj rekursit të paraqitur nga “CEZ Shpërndarje” sh.a., me vendimin nr. 00-2023-1534 (209), datë 12.4.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke gjetur të drejtë arsyetimin e kësaj të fundit. Sipas Kolegjit Civil, afati i parashkrimit pezullohet vetëm në rast se paditësi, krahas qenies i mitur, është edhe pa përfaqësues ligjor, pra vetëm në këtë rast ai është në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtën e padisë, çka justifikon mosveprimin e tij. Në interpretim gramatikor të nenit 129 të KC-së, lidhëza “ose” tregon se dy situatat, “gjersa t’u emërohet përfaqësuesi” ose “të fitojnë zotësinë për të vepruar” janë alternativa të njëra-tjetrës. Gjykata e apelit arsyeton në mënyrë të gabuar kur referon se shprehja “gjersa t’u emërohet përfaqësuesi” zbatohet për personat të cilët nuk kanë zotësi për të vepruar, ndërsa shprehja “të fitojnë zotësinë për të vepruar” për të miturit. Për nga mënyra se si është ndërtuar fjalia, këto dy shprehje, të cilat tregojnë dy situata ku pezullohet afati i parashkrimit, janë të zbatueshme për të dyja kategoritë e personave që nuk kanë zotësi për të vepruar, të miturit dhe personat e tjerë që nuk kanë zotësi për të vepruar. Për sa i takon interpretimit të këtyre dispozitave, kolegji ka vlerësuar se padia e kërkuësve për shpërblimin e dëmit është parashkruar, pasi është ngritur në tejkalim të afatit të parashkrimit 3-vjeçar të parashikuar në nenin 115, shkronja

“dh”, të KC-së, prandaj duhej rrëzuar (*shih vendimin nr. 00-2023-1534 (209), datë 12.4.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqet 6–7*).

29. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë disponuar vetëm në lidhje me ushtrimin e nga kërkuesit të së drejtës për të paraqitur kërkesëpadi për shpërblimin e dëmit jokontraktor, duke iu referuar më konkretisht afateve ligjore për paraqitjen e saj, sipas parashikimeve të KC-së. Kështu, në interpretim të dispozitave të KC-së që bëjnë fjalë për afatin ligjor për paraqitjen e kësaj padie dhe për parashkrimin e saj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vlerësuar se kërkesëpadia është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe se, ndonëse të mitur, kërkuesit kanë pasur përfaqësues ligjor, i cili ka pasur mundësi të ushtronte të drejtën e padisë në emër dhe për llogari të tyre. Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit Vlorë ka vlerësuar se kërkesëpadia është paraqitur në afat, pasi kërkuesit kanë qenë të mitur në kohën kur ka ndodhur ngjarja dhe se për kërkuesin Leonard Demaj afati i plotë i parashkrimit shues ishte fituar më datë 7.12.2013, 6 (gjashtë) muaj pasi ai kishte fituar zotësinë e plotë për të vepruar, ndërsa për kërkuesen Lirena Demaj afati vazhdonte të ishte ende i pezulluar. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, gjykata e apelit ka vendosur kthimin e saj për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, në interpretim të nenit 129, shkronja “d”, të KC-së në raport me nenet 112, 115, shkronja “dh”, 117, 120 dhe 136 të këtij kodi, në përfundim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e mbajtur nga gjykata e rrethit, duke arsyetuar se kërkuesit kanë pasur përfaqësues ligjor, i cili mund të ushtronte të drejtën e padisë në emër të tyre, për rrjedhojë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

30. Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues individual, përmes të cilit është vendosur prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së rrethit, është bazuar në nenin 485, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, që e parashikon këtë si një nga mënyrat e disponimit të Gjykatës së Lartë. Po kështu, Gjykata çmon të theksojë se, si rregull, kur ngrihen pretendime për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj nga Gjykata e Lartë, vlerësimi i saj mbështetet në analizën e vendimmarrjes gjyqësore të kundërshtuar, për të përcaktuar nëse Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të ndryshëm të fakteve dhe provave të çështjes nga gjykatat më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në thelb të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme qëndron interpretimi i dispozitave të KC-së në lidhje me parashkrimin e padisë në rastin e të miturve, çështje për të cilën kanë disponuar si gjykata e rrethit dhe ajo e apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë. Kthimi i çështjes së kërkuesve për rishqyrtim në gjykatën e rrethit është bërë nga gjykata e apelit për shkaqe që kishin të bënin me interpretimin e ligjit dhe jo me përcaktimin e fakteve. Po në këtë këndvështrim, në prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë bërë vlerësim të provave dhe as të ketë ripërcaktuar faktet e çështjes, por, në analizë të dispozitave përkatëse të KC-së, ka kontrolluar mënyrën e zbatimit të tyre nga ana e gjykatave më të ulëta, duke bërë interpretimin përfundimtar si gjykatë ligji.

31. Në kushtet kur interpretimi i ligjit në lidhje me të drejtën e ushtrimit të padisë dhe parashkrimin e saj përbën çështje tërësisht ligjore, kompetenca për të cilin i përket Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve se çështja duhej të ishte kthyer për shqyrtim në gjykatën e apelit, me qëllim që ajo të shqyrtohej në themel, janë të pabazuara, pasi e drejta e parashkrimit të padisë përbën parakusht për shqyrtimin e themelit të pretendimeve. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se në rastin e kërkuesve Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave të saj ligjore, duke interpretuar dispozitat e KC-së në lidhje me parashkrimin e padisë. Po kështu, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji ajo ka dhënë përgjigje përfundimtare në lidhje me thelbin e mosmarrëveshjes mes palëve dhe nuk rezulton të ketë cenuar të drejtën e kërkuesve për akses substancial.

32. Për sa më sipër, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar brenda hapësirës së saj si gjykatë ligji, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për shkaqet e vendimmarrjes së saj për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj në lidhje me të drejtën e aksesit substancial janë të pabazuara.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa nuk është e bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 9.4.2024

Shpallur, më 2.5.2024

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi